

Shpërfillet udhëzimi administrativ gjatë prerjes së blirëve

Arian Duriqi

LIPJAN, 21 DHJETOR – Komuna e Lipjanit ka shpërfillur udhëzimet administrative kur ka vendosur për heqjen e blirëve 50-vjeçarë në rrugën “Skënderbeu” dhe kur ka liruar hapësirat për trotuare. Sipas shoqërisë civile që vepron në këtë komunë, autoritetet komunale të Lipjanit heqjen e drunjve përgjatë kësaj rruge në qendër e kanë bërë pa konsultim paraprak me qytetarët, ndërsa kjo sipas tyre shkel udhëzimin administrativ për transparencën. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin e të rinjve YAHR ka thënë se ky veprim i ekzekutivit lipjanas është për t’u gjykuar rëndë.

“Organizata Joqeveritare YAHR shpreh keqardhje dhe shqetësimin mbi veprimet e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit, për heqjen e drunjve përgjatë rrugës “Skënderbeu”, vende të cilat kanë qenë hapësira gjelbëruese dhe simbol i qytetit të Lipjanit me dekada të tëra. Kjo heqje është bërë pa u konsultuar paraprakisht me mendimin e qytetarëve të qytetit të Lipjanit, duke shkelur udhëzimet administrative”, ka thënë Krasniqi. E sipas Udhëzimit administrativ për transparencën në komuna nr. 05/2013, në neni 7, të datës 12.07.2013, që ka të bëjë me konsultimet e publikut para miratimit të akteve, në pikën 1. thuhet: “Aktet e organeve të Ko-

munës, vendimet, rregulloret të cilat janë në interes i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit”. Kurse në pikën 2 thuhet; “Organi propozues përgatit projektaktin dhe cakton mënyrën e zhvillimit të konsultimit, afatin për konsultim, duke i përfshirë grupet e interesit, seancat dëgjimore me publikun dhe format e tjera të pjesëmarrjes së publikut”. Dhe, bazuar në këto dy udhëzime, OJQ YAHR po vlerëson se ekzekutivi i Komunës së Lipjanit para se të marrë vendimin në fjalë për largimin e drunjve, është dashur që të konsultohet me grupet e interesit, e në këtë rast që janë qytetarët e qytetit të Lipjanit. “Duhet dhe është e obliguar që institucionet lokale të respektojnë normat ligjore që të rritet vendimmarrja e qytetareve në vendimet që merr Komuna dhe që e atakojnë interesin e drejtpërdrejtë të tyre, dhe njëkohësisht që ta rrisë transparencën karshi qytetarëve më informim paraprak për raste të tilla”, ka thënë Krasniqi. Por kryetari i kësaj komune, Imri Ahmeti, ka thënë për media online se kjo organizatë nuk po e thotë mendimin e qytetarëve por mendimin e vet, dhe se po ashtu, sipas tij, paraprakisht është marrë mendimi i qytetarëve për ndërrimin e këtyre drunjve. Por, qytetarët që janë banues në qendrën e Lipjanit kanë thënë se asnjëherë nuk janë ftuar në konsulta për heqjen ose jo të drunjve, ndërsa ata



“Blirët 50-vjeçarë shkulen nga Lipjani nga pushteti i pazareve në komunën tonë. Ata drunj kanë qenë një e mirë e trashëguar me vite dhe janë ruajtur. Siç duket, kujdesi ndaj ambientit nuk është në kulturën e tyre. Nuk dinë për ambientin e pastër, gjelbërimin dhe natyrën, andaj turp për ta”, thuhet në reagimin e Rinisë Demokratike të Lipjanit

vazhdojnë të jenë të shqetësuar për këtë veprim. “Komuna nuk ka ftuar qytetarët në konsulta, këtë ka mundur ta bëjë me disa biznese që janë të afërta me Komunën në atë rrugë, por asnjëherë me qytetarët dhe kjo shqetëson dhe brengos shumë”, ka thënë Jusuf Kelmendi. E të dielën ka reaguar edhe Rinia Demokratike e Lipjanit lidhur me këtë çështje. Ata nëpërmjet një reagimi në rrjetin social e kanë quajtur turp veprimin. “Blirët 50-vjeçar shkulen nga Lipjani nga pushteti i pazareve në komunën tonë. Ata drunj kanë qenë një e mirë e

trashëguar me vite dhe janë ruajtur. Siç duket kujdesi ndaj ambientit nuk është në kulturën e tyre. Nuk dinë për ambientin e pastër, gjelbërimin dhe natyrën, andaj turp për ta”, thuhet në reagim. E për këtë rast ka reaguar edhe Rabbit Konjufca, ish-kandidat për kryetar të Lipjanit. Ai ka ironizuar duke thënë se pushteti tashmë ka bërë drunj të mjaftueshëm për ngrohje. “I lumtë këtij pushteti, sepse kështu investohet për gjeneratat e ardhshme”, ka ironizuar shkurt ai.

© KOHA Ditore

Carita

Vitis
k

VITI, 21 DHJETOR – Marrëveshje mes Komunës së Vitisë dhe zvicercanëve, jektit për konkretizimin e ndryshme të Sinani, drejt ka thënë se të Caritasë shkolla të Vitisë zohen me konkretizimin cesin edukativ e shkollave për mjete kompjuterike mbështetje tasi zvicercanë të madhe që dhe në të ardhme probleme për që janë të dëmta me nxënës, e karrige për mjetet e tjera punë të përcaktuara thënë Sinani has shkollave parashihet Çerdhen e f